



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1111 Prot.

Tiranë, më datë 25.11.2020

VENDIM

Nr. 428, datë 25.11.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.11.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Godinë banimi 2 kate. Rikonstrukcion i objektit ekzistues dhe shtesë volumi pa ndryshim funksioni”, në rrugën “Isuf Molla”, Zona arkeologjike “B”, Durrës, me subjekt investitor “Besim Roçi” dhe raport i sondazheve arkeologjike i realizuar nga person i licencuar në arkeologji L.Përzhita.
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e projektit “Godinë banimi 2 kate. Rikonstrukcion i objektit ekzistues dhe shtesë volumi pa ndryshim funksioni”, në rrugën “Isuf Molla”, Zona arkeologjike “B”, Durrës, me subjekt investitor “Besim Roçi” si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt.
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elva MARGARITI

SEKRETAR

Arta DOLLANI

Arta
Dollani

Digitally signed by Arta Dollani
DN: cn=Arta, o=Instituti i
Monumenteve të Kulturës,
title=Drejtor i Përgjithshëm,
cn=Arta Dollani
Date: 2020.11.25 17:51:52
+01'00'

Elva Margariti

Digitally signed by Elva
Margariti
Date: 2020.11.25 18:05:11
+01'00'